

## Shtegtimi mbarëkombëtar në Genazzano dhe Qytetin e amshuar në Romë

Me rastin e shënimit të Vitit të Fesë (2013) dhe përvjetorit të Ediktit të Konstantinit (313-2013), me të cilin të krishterët fituan lirinë e fesë, pastaj 20-vjetori i vizitës së të Lumturit Papës Gjon Pali II Shqipërisë, nga Konferenca Ipeshkvore e Shqipërisë, Arqipeshkvia e Tivarit dhe Administratura Apostolike e Prizrenit u organizua një shtegtim historik i shqiptarëve në Genazzano dhe Qytetin e amshuar - Romë.



Genazzano - vend shtegtimi historik i shqiptarëve

Me qytezën e Genazzano-s, ne shqiptarët kemi një lidhje të ngushtë shpirtërore për shkak të Shenjtërores së Zojës së Këshillit të Mirë. Që nga shekulli XV, ky vend me plotë të drejtë quhet vend shtegtimi i shqiptarëve. Shenjtëroret e Zojës, si në Shkodër, ashtu në Genazzano apo edhe kudo nëpër kishat tona në Kosovë, e më gjerë, janë bërë vend shtegtimi për shumë besimtarë, sepse aty përjetohet dora e ëmbël e Nënës qiellore, afërsia e saj që na bën të ndjehemi pronë e Zotit. Prandaj, ndër ne shqiptarët, duhet shtuar edhe më shumë përshtirëria ndaj Asaj që është Pajtore e jona.

Nëna e Këshillit të Mirë, ka dëshmuar kujdes të madh ndaj nesh si popull sidomos në rrethana të vështira historike që kemi përjetuar. Pra, kjo është ajo Nënë që na bashkon rreth vetes kah do që jemi, si në trojet tona ashtu edhe kudo nëpër botë. Kjo u dëshmuar me pjesëmarrjen në këtë shtegtim, si të shqiptarëve nga viset e ndryshme etnike, ashtu nga diaspora. Përjetimi ishte edhe më i veçantë për të posa pagëzuarit, dhe bashkë me ta, edhe për ne që përjetuam afërsinë e Nënës qiellore në Genazzano dhe të Kryepostujve Shën Pjetrit dhe Shën Palit në Romë.

Edhe gjatë këtij shtegtimi, u dëshmuar se fara e Ungjillit e mbjellur në tokat shqiptare, dhe krishterimi i vulosur me predikimet e Shën Palit, i cili në misionet e veta përshkoi vendet deri në Ilirik duke e përhapur mësimin e Jezu Krishtit, ka dhënë dhe vazhdon të jep frytet e veta, dhe janë dëshmi se populli ynë kurrë nuk e ka braktisur besimin në Krishtin e Ringjallur. Për më tepër, populli ynë jo vetëm se në Personin e Krishtit e ka njohur Zotin, por e ka fituar edhe ndërmjetësuesen e mrekullueshme, Zojën e Bekuar, të cilën Krishti na e la për Nënë tonë. Shumë herë është dëshmuar edhe ndër ne thënia e Tertulianit: “Gjaku i martirëve, fara e të krishterëve”. Në këtë kontekst, pas vdekjes së Gjergj Kastriotit (1468) populli ynë pëson Kalvarin e rëndë, dhe, që nga ajo kohë, me ndërmjetësinë e Nënës së Këshillit të Mirë – do t’i

mbetet besnik Zotit, dhe përkundër sfidave të vështira do të ruaj vlerat kombëtare e fetare, duke shpëtuar kështu identitetin e vet.

Në trojet tona ka shumë themele të kishave dhe bazilikave të cilat i ka mbuluar hija e së kaluarës sepse nuk arritën të bëjnë ballë salvimeve të shumta. Por devocioni ndaj Zojës nuk u shua kurrë dhe u ka bërë ballë të gjitha vështirësive, kjo për faktin se buronte nga zemrat e mbushura me Shpirtin e Zotit, e që me shpresë të madhe i luteshin Asaj; *“Ktheu o Zoja e Këshillit të mirë! Qysh atë ditë që je largue një mijë të zeza na kanë mbulue. Ktheu oj Nanë me na ndihmue...”*.

Prandaj, Zoja e Këshillit të Mirë, e cila që prej kohërave të lashta nderohet ndër ne, dhe historia e saj që është e lidhur me historinë e krishterimit shqiptarë, na shoqëron pa nda dhe në çdo moment. Për këtë arsye, lidhja jonë shpirtërore me Të, na shtynë t’i kushtohemi çdo ditë e më shumë dhe ta ruajmë miqësinë e shenjtë me Të.



### **Nëna e Këshillit të Mirë – largimi i Saj nga Shkodra**

Djepi i kulturës dhe Fesë ndër shqiptarë, Shkodra, pak para vdekjes së Gjergj Kastriotit përjetonte një rrethim dhe po bënte një jetë në ankth, sepse ushtria turke shtohet ditë për ditë dhe përgatitej për pushtim të këtij qyteti.

Si rrjedhim i ngjarjeve më pas, perandoria otomane do të pushtoj shumë toka shqiptare. Ajo ishte e prirë të shkatërroj gjithçka që përbënte identitetin e një populli, duke provuar ta tjetërsoj atë, natyrisht pa kursyer aspak vendet e kultit. Kjo fatkeqësi e priste, ndër shumë tjera, edhe kishën e Zojës së Këshillit të Mirë – e njohur si Kisha e Zojës së Shkodrës.

Në të njëjtën periudhë, që lidhet mirë me ngjarjet e mëvonshme, në vitin 1467, një grua e vejë në Genazzano, e shpallur e Lumtur nga Papa Klementi

XIV në vitin 1735, i shpenzon të gjitha të mirat materiale për restaurimin e një kisha të vjetër të vitit 1356 që ishte e kushtuar “Zojës së Këshillit të Mirë”. Këto mjete nuk mjaftonin, kështu që ajo i qetëson banorët e shqetësuar duke u thënë: “Bijtë e mi, mos u brengosni, para se unë të vdes (ishte e moshuar), Zoja e Bekuar dhe Shën Augustini do t’i përfundojnë punimet në këtë kishë”.

Tani, pas invadimit të turqve në Shkodër, po të njëjtin vit (1467), afresku që paraqet Zojën e Këshillit të Mirë me Krishtin në dorë, mrekullisht shkëputet prej murit për të shpëtuar shkatërrimit. Dy njerëz të devotshëm, Giorgi dhe De Sclavis e shohin figurën e shenjtë duke fluturuar e shoqëruar nga engjëjt. Te dy vendosin ta përcjellin, dhe me mrekullinë e Zojës, e kalojnë këmbë detin Adriatik. Më 25 prill 1467, gjatë festës së Shën Markut kjo figurë arrin dhe vendoset në kishën që po restaurohej në Gennazano. Ky lajm do të përhapet shpejt dhe fillojnë të vijnë shumë shtegtarë nga e gjithë Italia. Falë shërimeve e mrekullive të shumta me ndërmjetësinë e Zojës Bekuar, aty lihen shumë lëmosha dhe kështu, jo vetëm se ndërtohet kisha por edhe kuvendi afër saj.

Pas kësaj ngjarje, Papa Pali II, i dërgon në Genazzano dy ipeshkvij që të merren me vërtetësinë e këtij rasti: Ipeshkvin Gaucerio de Forcalquier nga Franca dhe Nicola de Crucibus, ipeshkëv i Hvarit në Dalmaci. Që atëherë, me ndërmjetësinë e Zojës Bekuar, në Genazzano ndodhin shumë mrekulli tjera të shërimeve nga sëmundjet e ndryshme.



### **Basilika e Zojës në Genazzano**

Nga kisha e vjetër nuk ka mbetur tjetër përveç ballinës dhe portës e gdhendur në mermer të bardhë, mbi të cilën është një relief që paraqet mbi mjegulla Zojën me Krishtin Fëmijë. Shenjtërorja aktuale është e ndërtuar mes viteve 1621 deri më 1629, pa e prekur apo ndërhyrë në kapelën e Zojës. Gjatë ndërtimit të Shenjtërores

së re, është përfshirë edhe kisha e vjetër e vitit 1356.

Fasada është ashtu siç është realizuar më 1840. Është e stolitur me gjashtë shtylla dhe katër mozaikë. Pastaj, Zoja e Këshillit të Mirë me dy engjëj para vetes, dy të tjerë në nderim të Papës Piu IX dhe Papës Luani XIII, të cilët ishin shumë të lidhur më këtë Shenjtërore. Mozaikët janë të vitit 1956 të autorit F. D'Urso, që paraqesin Shën Shtjefnin Bellesini në mesin e të sëmurëve. Në Shenjtërore arrihet përmes pesë shkallëve dhe tri dyerve prej të cilave njëra është zëvendësuar në vitin 1966 me një derë prej bronzi.

Brendia e Shenjtërores ka tri anije apo kalime, presbiter të gjerë, lteri i madh monumental dhe kori prej druri. Në hyrje të Kishës, majtas është lteri kushtuar Shën Nikollës së Toledos, pastaj lteri i Shpirtit Shenjtë në të cilin paraqitet fryma e Rrëshajave. Kjo vepër është e fillimit të shekullit XVII, ndërsa kori është i ndërtuar rreth vitit 1777. Pjesë të presbiterit janë pasuruar me gjashtë afreske të tjerë.

Në pjesën e mesme të anijes së kishës, paraqiten figura të grave të shenjta nga Besëlidhja e Vjetër, ndërsa lart, brenda mureve paraqitet kurorëzimi i Zojës së Ngritur në Qiell. Lteri i të Kryqëzuarit ruan një afresk të Krishtit të Kryqëzuar nga shekulli XV. Lteri i madh është i pasur me mermer polikromi të cilin e sjellin nga Roma, në fillim i vendosur në kishën e Shën Piu-t në Genazzano, pastaj nga etërit irlandez augustinian i dhurohet kësaj Shenjtëroreje.



### **Kapela e Zojës së Këshillit të Mirë**

Në fund të anijes së majtë të kishës është kapela e Zojës, e cila është e rrethuar dhe mbrojtur me hekur. Kjo rrethojë është e punuar në vitin 1630. Në lterin brenda kapelës, që është i veshur së pari me argjend pastaj me ari, i punuar në vitin 1819, gjendet figura e Zojës së Këshillit të Mirë, e cila kurorëzohet nga Kapitulli i Vatikanit më 25

nëntor 1681. Kjo figurë është e pikturuar në formë teknike afresku në format 45x40 cm.

Punimet e lterit kanë përfunduar më 1734, në saje të bujarisë së Kardinalit Aleksandër Albanit, me ballore prej alabastrit të lulëzuar, pastaj pasqyra anësore të pjesës kryesore të lterit dhe mermerë në formë shtyllash alabastrit oriental. Muret e kapelës janë të mbuluara me afreske që paraqesin vizitat e Papëve si ajo e Urbanit VIII, Piu-t IX dhe Gjonit XXIII.

## **Papët shtegtarë në Genazzano**

Papët kanë dëshmuar një nderim të veçantë ndaj Shenjtërores së Zojës së Këshillit të Mirë në Genazzano. Shumë prej tyre në forma të ndryshme kanë mbështetur këtë Shenjtërore dhe ngjarjen që lidhet me të, ndërsa disa prej tyre edhe kanë shtegtuar atje.

Lidhur me këtë Shenjtërore, Papa Pali II, në vitin 1467 dërgon dy ipeshkvi të hulumtojnë rastin e asaj që kishte ngjarë në Genazzano, për çka shumë njerëz nga e gjithë Italia kishin filluar ta vizitojnë këtë vend.

Pastaj, Papa Siksti IV, më 15 qershor 1475 konfirmon kalimin e kishës në administrimin e etërve augustinian, ndërsa Papa Aleksandri IV, pasi kishte marrë informatën se njerëz të panjohur e kishin plaçkitur kuvendin, më 15 maj 1502 ekskomunikon ata njerëz.

Papa Gregori XII, lejon të jepet ndjesa e plotë për shpirtrat e purgatorit, të gjithëve që kremtojnë meshën në lterin e Zojës bekuar.

Papa Inocenti XI, më 17 nëntor 1682 urdhëron që Zoja të kurorëzohet me kurorë të dyfishtë prej ari. Ndërsa, Papa Klementi XII, jep ndjesën e plotë me rastin e festës së lajmërimit (25 prill – dita kur Zoja arrin në Genazzano) si dhe gjatë tetë ditëshit, të gjithë shtegtarëve të devotshëm të Shenjtërores.

Benedikti XIV, me dokumentin “Iniunctae Nobis”, të 2 korrikut 1753 aprovon “Shoqërinë e të Devotshmëve” të Zojës së Këshillit të Mirë. Në vitin 1790 në këtë Shoqëri ishin të regjistruar 190.000 njerëz.

Papa Luani XIII, në pamundësi që ta vizitoj Shenjtëroren, do të bëj shumë në përhapjen e përshpirtërisë ndaj Zojës së Këshillit të Mirë në mbarë botën. Në vitin 1884 aprovon Meshën e kushtuar Zojës në ditën e festës më 26 prill; më 1892 lejon ndarjen e ndjesës së plotë; më 17 mars 1903 Shenjtëroren e ngrit në Bazilikë të Vogël; ndërsa më 22 prill 1903 urdhëron që në litanitë lauretane, pas thirrjes: Mater admirabilis (Nëna e mrekullueshme), të shtohet edhe Nëna e Këshillit të Mirë.

Sa i përket vizitës së parë të një Pape në Genazzano, atë e realizon Papa Urbani VIII, më 21 tetor 1630. Pastaj, vizita e dytë është ajo e Papës Piu-t IX më 15 gusht 1864. Ditën e festës së Zojës të Ngritur në Qiell, nga rezidenca verore në Castel Gandolfo, Papa niset drejt Genazzano-s në përcjellje të stafit dhe prelatëve të shumtë.

Vizita e tretë e një Pape në Genazzano është ajo e Gjonit XXIII, më 25 gusht 1959. Për dallim nga Papët tjerë që kishin shtegtuar në Genazzano, ky shtegton atje më i heshtur dhe pa manifestime publike.

Vizita e katërt është ajo e Gjon Palit II, më 22 prill 1993. Me këtë rast Papa vlerëson lart lidhjen e ngushtë të qytetarëve të Genazzano-s me Zojën e Këshillit të Mirë dhe me Papën.

## **E lumtura Nëna Tereze dhe Genazzano**

Shenjtëresha e ditëve tona, Nënë Tereza, ishte shumë e devotshme ndaj Zojës së Këshillit të Mirë. Ajo, si të gjithë shqiptarët e përshpirtshëm, disa herë kishte ardhur në Shenjtëroren e ashtu quajtur “të shqiptarëve” në Genazzano. Vizita e saj e fundit në këtë Shenjtërore ishte më 10 qershor 1993. Me këtë rast ajo e le të shkruar këtë lutje: *“O Mari, Nëna e Jezusit; kthehu në shtëpi, në Shqipëri. Ne të duam, ne kemi nevojë për ty. Ti je Nëna jonë. Kthehu në shtëpi. Në Shqipëri. Të lutemi.”*

Nëse jo afresku origjinal i Zojës së Këshillit të Mirë, një kopje e ngjashme me të, u kthye në Shqipëri. Papa Gjon Pali II, pasi e kishte bekuar në Genazzano, solemnisht e riktheu në Shenjtëroren e Shkodrës më 25 prill 1993. Me këtë rast, Ati i Shenjtë, pati nderuar me admirim qëndresën dhe flijimet e shumta për Fe e Atdhe të klerikëve dhe shumë laikëve të devotshëm dhe të mbarë popullit Shqiptar.

Përgatiti: Don Agim Qerkini